



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA KORÇË

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 84 Datë 29-08-2025

**PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR RININË NË
BASHKINË KORÇË 2025-2028**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Qendra Sportive Korçë përmes Qendrës Rinore Korçë, duke bazuar në nenin 9 pika 1.1, 24, 54, 64 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, K.Pr. Administrative, Ligjit 75/2019 "Për Rininë", Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë sipas materialit bashkëngjitur "Planin Lokal Të Veprimit Për Rininë Në Bashkinë Korçë 2025-2028".

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Qendra Sportive Korçë, Drejtoria e Turizmit, Projekteve, Zhvillimit dhe Migracionit e Diasporës, Drejtoria e Kujdesit Social, Sektori i Integritimit European, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Eva Naçi



Miratuar me 22 vota

Vota Pro 22

Vota Pro 22

Vota Kundër 1

Vota Abstenim 4

Zbardhur më datë 29-08-2025

KRYETAR





Bashkia Korçë

Koha për Korçën

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË NË BASHKINË KORÇË (2025-2028)

Lentësuar nga:

Mbështetur nga:



"Rinia ka potencial dhe ne duhet të kemi kurajon të ndërrojmë mendësitë dhe praktikat e vjetra dhe ta orientojmë fuqinë e tyre drejt qëllimeve të mira." - Mary McLeod Bethune

PËRMBAJTJA

- I. Hyrje
- II. Misioni dhe Vizioni
- III. Metodologjia e ndjekur për përgatitjen e Planit
- IV. Perpjekjet për të rinjtë në nivel lokal dhe qendror
- V. Të rinjtë në Korçë, të dhëna demografike
- VI. Identifikimi i problemeve, nevojave dhe problemeve të rinisë
 - 1. Punësimi dhe sipërmarrja rinore;
 - 2. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në politikë dhe vendimarrje;
 - 3. Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës;
 - 4. Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike për të rinjtë;
 - 5. Mbështetja e organizatave dhe nismave Rinore.
- VII. Matrica e Prioriteteve për të Rinjtë 2025-2028
- VIII. Buxhetimi i Planit të Veprimit
- IX. Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit

Bibliografia

I. HYRJE

Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2025-2028, ka si qëllim avancimin e të gjithë të rinjve dhe të rejave që jetojnë, punojnë dhe studiojnë në Korçë, duke nxitur ndërmarrjen e veprimeve aktive, që synojnë përfshirjen e të rinjve në jetën sociale, politike, ekonomike dhe vendimarrëse. Ky plan synon t'i vendosë të rinjtë dhe të rejat në qendër të vëmendjes të punës dhe përpjekjeve të Bashkisë Korçë përgjatë 3 viteve të ardhshme, duke i konsideruar ata një komponent të rëndësishëm në avancimin qytetar dhe pjesmarrjes së tyre në vendimarrjen vendore.

Prioritetet/aksionet e propozuara bazuar në këto pika:

- Situatën aktuale të të rinjve në Korçë;
- Problemet dhe sfidat me të cilat përballlet Bashkia e Korçës për rritjen e pjesmarrjes së të rinjve në jetën politike, ekonomike dhe sociale;
- Mundësitë dhe vizionin e Bashkisë Korçë për avancimin e të rinjve, si qytetarë aktivë dhe pjesëmarrës në proceset e ndryshimit të njësive administrative.

Duke iu referuar numrit të të rinjve dhe nevojave që ata kanë, mund të theksojmë se megjithëse ka pasur një implementim të Planit Lokal të Bashkisë Korçë për të Rinjtë 2022-2023, si dhe ekzistenca e Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë dhe Strategjisë Kombëtare 2022-2029, ka ende mundësi për një angazhim më të thelluar dhe një planifikim më të detajuar në adresimin e këtyre nevojave në nivel lokal.

Problematikat që të rinjtë raportojnë, janë përmbledhur në 5 prioritet kryesore:

1. *Punësimi dhe sipërmarrja rinore;*
2. *Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në politikë dhe vendimarrje;*
3. *Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës;*
4. *Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike për të rinjtë;*
5. *Mbështetja e organizatave dhe nismave rinore.*

Pavarësisht përpjekjeve të bëra deri tani, të rinjtë në Korçë ende kanë nevojë për një plan të qartë veprimesh që adreson shqetësimet dhe nevojat e tyre, duke synuar përmirësimin e shërbimeve dhe mundësive që i fuqizojnë ata. Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2022-2023 ka qenë një bazë e mirë dhe ndihmuese për këtë proces, dhe ka shërbyer së tepërmi si pikënisje për zhvillimin e këtij Plani të ri. Ky plan i ri do të përfshijë objektiva të qarta dhe rezultate të prekshme për secilin nga 5 prioritetet e identifikuara, të cilat përshkruhen më poshtë:

Prioriteti 1 - Punësimi dhe sipërmarrja rinore përfshin dhe adreson papunësinë e të rinjve (duke përfshirë sidomos okupacionet sezonale ose studentore), efektshmërinë e politikave që janë në fuqi për të incentivuar punësimin rinor, si dhe të rinjtë si sipërmarrës. Ky prioritet adreson

- Së pari, të identifikojë problemet, nevojat dhe prioritetet e të rinjve të Korçës. Kjo është arritur përmes opinioneve të marra nga të rinj në gjimnaze, si dhe NGO-ve e shoqatave rinore, gjatë 1 workshopi në nivel bashkie dhe një workshopi rajonal të zhvilluar në kuadrin e procesit të përgatitjes së kësaj strategjie, gjatë vitit 2024. Një tjetër kanal informimi për mendimet dhe opinionet e të rinjve kanë qenë tre studime dhe raporte kombëtare për rininë shqiptare të organizatës CRCA/ECPAT Shqipëri dhe Rrjetit Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri - ANYN.
- Së dyti, të propozojë zgjidhjet e mundshme ose fushat e ndërhyrjes, nëpërmjet mënyrave, mekanizmave dhe mjeteve të caktuara, për të adresuar problematikat e dala.

Planit Lokal i Veprimit për të Rinjtë fokusohet në periudhën 2025 - 2028.

III. METODOLOGJIA E NDJEKUR PËR PËRGATITJEN E PLANIT

Procesi i hartimit të Planit Lokal të Veprimit të Bashkisë Korçë për të Rinjtë, filloi në nëntor 2023 dhe vijoi deri në muajin dhjetor 2024. Metodologjia e ndjekur për hartimin e Plan Veprimit konsiston në 6 etapa të ndryshme. Ky Plan Veprimi është realizuar me përfshirje të gjerë të vetë të rinjve, si dhe me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm të cilët kanë të bëjnë me realizimin e 5 (pesë) prioritetëve të identifikuar. Për të arritur në rezultatet e këtij Plan Veprimi është aplikuar një metodologji mikse ku përfshihen rishikim literature për sa i përket modeleve të suksesshme të plan veprimeve të ngjashme, intervista gjysëm të strukturuar dhe takime me aktorët kyç. Këto etapa janë zhvilluar në rend kronologjik, pasi etapa pararendëse është kusht përmbushës për atë që pason.

Etapat e metodologjisë përfshijnë:

1. *ETAPA 1-Faza përgatitore;*
2. *ETAPA 2-Identifikimi i prioritetëve;*
3. *ETAPA 3-Bashkëpunimi me institucione dhe drejtori të Bashkisë Korçë;*
4. *ETAPA 4-Konsultim me përfaqësuesit e Bashkisë Korçë;*
5. *ETAPA 5-Prezantimi publik;*
6. *ETAPA 6-Aprovimi nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak.*

ETAPA 1 - Faza përgatitore, përfshin hartëzimin e të gjithë punës për ndërtimin e këtij plan veprimi. Si fillim u realizuar përfshirja e të rinjve për identifikimin e nevojave, shqetësimeve dhe problematikave të tyre. Të rinjtë e përfshirë përbëhen nga nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në qytetin e Korçës, përfaqësues të organizatave dhe grupeve rinore si dhe përfaqësues të Këshillit Rinor Vendor në qytetin e Korçës. Këto të rinj nën facilitimin e ekspertëve

gjërë. Ky feedback është kthyer në komente e sugjerime, të cilat janë reflektuar në versionin final që do i paraqitet kryetarit të Bashkisë Korçë dhe Këshillit Bashkiak të Korçës.

ETAPA 6 - Aprovimi nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak, në këtë fazë Plan Veprimi në formën e një versioni final i dorëzohet Kryetarit të Bashkisë Korçë dhe Këshillit Bashkiak të Korçës për aprovim. Pasi kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak e shqyrton në mbledhjen e tij ose në një formë tjetër, përcaktohet aprovimi dhe versioni final i këtij Plan Veprimi.

Partnerët janë komponent shumë i rëndësishëm i një strategjie, së pari sepse cilësia e tyre ndikon direkt në cilësinë e produktit, dhe së dyti gjithanshmëria e tyre *(pra një gamë e gjerë aktorësh të përfshirë në proces)*, e bën produktin më të besueshëm dhe cilësor. Në procesin e hartimit të kesaj strategjie janë përfshirë partnerët e mëposhtëm:

- Autoritetet e pushtetit vendor: Bashkia e Korçës *(më specifiku: Drejtoria e Turizmit, Projekteve, Zhvillimit dhe Migracionit e Diasporës, Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave, Tarlfave Vendore dhe Kontrollit Territorit, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Kujdesit Social, Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale, Agjencia e Mirëqenies dhe Kujdesit Social, Sektori i Integrimit Europian, Sektori i Bujqësisë, si dhe Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit)* dhe 8 Njesitë Administrative.
- Organizatat, grupimet dhe këshillat rinore që operojnë në nivel lokal dhe qendror: Këshilli Rinor Vendor Korçë, Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri (ANYN), Këshilli Rinor Kombëtar - KRK.
- Ofruesit e shërbimeve për rininë *(Drejtoria e Rinisë, Drejtoria e Punësimit, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale)*.

IV. PERPJEKJET PËR TË RINJTË NË NIVEL VENDOR DHE QËNDROR

Në Shqipëri, periudha 2013-2024 ka parë zhvillime të rëndësishme në kuadrin ligjor dhe strategjitë për të rinjtë. Këto përpjekje synojnë të adresojnë nevojat e rinisë dhe të ofrojnë mbështetje në fusha të ndryshme si arsimi, punësimi, shëndeti dhe pjesëmarrja në jetën shoqërore dhe politike. *Më poshtë është një përmbledhje e kuadrit ligjor, institucional dhe strategjive kryesore për të rinjtë në nivel qendror gjatë kësaj periudhe:*

1. KUADRI LIGJOR

1.1. LIGJI PËR RININË¹

Përgjatë pesë vjeçarit të fundit një hapësirë të madhe zuri procesi i draftimit, miratimit dhe zbatimit të Ligji Nr. 75/2019 "Për Rininë". Objekti i këtij ligji është mbrojtja e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të të rinjve shqiptarë në diasporë, si dhe financimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti.

Pesë vite nga miratimi, hyrja në fuqi dhe zbatimi i Ligjit për Rininë, marrë shkas nga disa mangësi të theksuara që po shfaq zbatimi i tij, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka iniciuar një proces të gjerë konsultimi me të rinj e të reja, përfaqësues të organizatave rinore dhe atyre për të rinjtë, përfaqësues të institucioneve publike vendore dhe qendrore, për kryerjen e ndryshimeve përkatëse të nevojshme.

1.2. LIGJI PËR ARSIMIN

Ligji Nr. 69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar":² Ky ligj ka si qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit të mesëm dhe orientimin e tij për të përmbushur nevojat e tregut të punës dhe të rinisë.

¹ Ligji Nr. 75-2019 "Për Rininë", lidhja në linkun vijues: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Permbledhje-e-ligjit-dhe-akteve-n%C3%ABnligjore-n%C3%AB-fush%C3%A8n-e-rinis%C3%AB.pdf>

² Ligji Nr. 69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar", lidhja në linkun vijues: https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Ligji_Parauniversitar.pdf

Ligji ka për qëllim rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe programeve publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimit profesional.

1.4. LIGJI PËR SHËNDETIN

*Ligji Nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor"*⁵: Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen me të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime të shëndetit mendor. Ligji përcakton procedurën dhe kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor, nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, sigurimit të një mjedisi social të përshtatshëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe nëpërmjet politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

1.5. LIGJ PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

*Ligj Nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"*⁶: Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Shërbimet e kujdesit shoqëror janë të organizuara si shërbime në komunitet, institucione të kujdesit dhe familje për të gjitha kategoritë e identifikuara të përfituesve. Llojet e shërbimeve shoqërore janë si më poshtë:

- a) shërbimet parashoqërore;
- b) shërbimet në qendrat komunitare, përfshirë qendrat e zhvillimit;
- c) shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat;
- ç) shërbimet shoqërore në situatë emergjence;
- d) shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror;
- dh) shërbimet e specializuara;
- e) shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line.

Shërbimet e kujdesit shoqëror janë shërbime rezidenciale kur është i pashmangshëm dhe i papërshtatshëm ofrimi i tyre në familje apo komunitet.

⁵ Ligji Nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", lidhja në linkun vijues: https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Ligji_Nr.44_2012_per_shendetin_mendor.pdf

⁶ Ligj Nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", lidhja në linkun vijues: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2016/11/24/121-2016>

2.2. STRATEGJIA KOMBËTARE E RINISË DHE PLANI I VEPRIMIT 2022-2029

Në vijim të Ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë", i cili siguron bazën ligjore për hartimin e politikave dhe programeve strategjike për rininë, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me anëtarët e grupit të punës ndërministror, kanë hartuar Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, si dhe Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029.

Sikurse cituar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 – 2024 (faqe 408), se: *"Strategjia Kombëtare për Rininë 2022 – 2029 do të jetë dokumenti ku do të bazohen politikat për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve. Ky dokument do të synojë hartimin e politikave rinore kombëtare integruese, për adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballen sot të rinjtë e që lidhen me sfida si, përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve në lidhje me artet dhe zejet, shtim të aktiviteteve sportive, vullnetarizëm etj. Strategjia Kombëtare për Rininë 2022 – 2029 do të jetë në përputhje me Strategjinë Evropiane për Rininë 2019 – 2027."*

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 është e para strategji e dedikuar për rininë në Shqipëri, duke i dhënë kaq fokus dhe rëndësi rinisë, edukimit, talenteve të tyre dhe kërkesave që ata kanë në fusha të ndryshme.

Në bashkëpunim me të rinjtë anë e kënd Shqipërisë, është konceptuar dhe hartuar Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029, e para strategji 8 vjeçare, që përfshin të gjitha masat dhe projektet që do të ndërmerren, me qëllim krijimin e një Shqipërie më të mirë për të rinjtë. Strategjia e Rinisë 2022-2029 është krijuar në thelb nga vetë të rinjtë nëpërmjet një procesi konsultimi të organizuar në disa faza që ka zgjatur nga gushti i vitit 2021 deri më shkurt të vitit 2022, ku ata ngritën shqetësimet e tyre, duke i thënë problematikat që kanë në përditshmëri në zonat ku jetojnë. Ata shprehën idetë dhe mendimet që mund t'ju japin zgjidhje kërkesave të tyre.

Politika kombëtare e strategjisë së rinisë dhe përpjekjet programuese përqendrohen në sigurimin e barazisë së mundësive dhe të drejtave, mbështetjes dhe angazhimit për të rejat dhe të rinjtë që janë më të prekshëm, të marginalizuar dhe më të goditur nga mungesat e shumta, të tilla si varfëria, dhuna, keqtrajtimi, paaftësia dhe përjashtimi social. Kjo strategji synon të orientojë rininë shqiptare për veprim të mëtijshëm i cili ndikon pozitivisht në të ardhmen e tyre.

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 ka tre qëllime politike:

- Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financiar.

Në këtë dokument parashtrohen edhe këto objektiva strategjike:

- *Mbështetja dhe Integrimi i të rinjve në tregun e punës, si punë marrës dhe sipërmarrës;*
- *Nxitja dhe thellimi i pjesëmarrjes së të rinjve në shoqëri, vendimmarrje dhe mirëqenie; dhe*
- *Forcimi i arsimit dhe formimit profesional për të rinjtë në të gjitha nivelet dhe shtimi i mundësive për të mësuar gjatë gjithë jetës;*

Të lidhura ngushtë me rininë janë edhe pjesë të tjera të kësaj strategjie shtyllat 2, 3 dhe 4 që kanë të bëjnë me rritjen ekonomike përmes konkurrueshmërisë dhe novacionit, investimin në kapital njerëzor dhe kohezionin social, si edhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit.

2.4. PLANIN KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN (PKIE) 2022-2024

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022-2024 thekson se: Ideja e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022–2029 vjen si një domosdoshmëri jo vetëm me miratimin e Ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”, por edhe për faktin se në dhjetor 2020 ka përfunduar “Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015–2020”. Në këtë mënyrë ky plan e vendos si prioritet të tij rininë si edhe miratimin e kësaj strategjie brenda tremujorit të tretë të këtij viti. Më gjerësisht çështjet me rininë si grup i caktuar shoqëror me interesa dhe nevoja të veçanta trajtohen në kapitullin 26 (fq.400), kapitull i cili në tërësinë e vet përfshin çështje të rëndësishme për rininë siç janë arsimi dhe kultura.

Çështjet që kanë të bëjnë me rininë ky plan i shikon edhe në aspektin e bashkëpunimit dhe integritetit rajonal dhe tema si “Investimi te Rinia në të Ardhmen Evropiane” kanë marrë prioritet në proceset e asocim stabilizimit dhe integritetit me Bashkimin Evropian. Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 22.9.2021, “Rinia” tashmë është fushë e përgjegjësisë së Ministrisë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, për pasojë dhe puna për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë ka kaluar në këtë ministri.

Përveç trajtimit të çështjeve ikonike të rinisë që lidhen me përmirësimin e cilësisë në arsim, mundësitë praktike për të vënë në zbatim dijet e marra, këshillimin për karrierë dhe argëtimin larg veseve dhe praktikave jo të ligjshme, ky plan ka prerje me strategjinë edhe në këto fusha të tjera të veprimit të tij:

- *Programi Kombëtar i Praktikave të Punës.*
- *Programi kombëtar “Edukimi për artet dhe zejet në institucionet arsimore parauniversitare”.*

3. POLITIKAT, PROGRAMET DHE PLANET NË NIVEL LOKAL NË KORÇË

3.1. PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2020-2023 (KORÇË)

Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2020-2023 (Korçë) u bë i mundur falë mbështetjes së plotë të Fondacionit Friedrich Ebert, i cili mbështet zhvillimin e politikave rinore në nivel vendor dhe qendror, në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar.

Qëllimi i këtij Plani Veprimi ishte hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të nxiste zhvillimin e një rinie të kulturuar dhe të shëndetshme, që mund të luajë një rol aktiv në demokratizimin dhe zhvillimin ekonomik vendor. Në veçanti, pjesëmarrja e rinisë në jetën publike dhe forcimi i statusit socioekonomik të saj përbëjnë një domosdoshmëri për arritjen e standardeve europiane dhe një ekonomie tregu të aftë për t'u përballur me sfidat e globalizimit.

Plani Lokal i Veprimit u frymëzua nga vizioni evropian mbi angazhimin qytetar, forcimin ekonomik, mbrojtjen sociale dhe zhvillimin kulturor të të rinjve në Bashkinë Korçë. Përparësitë e angazhimit strategjik kishin për synim shfrytëzimin optimal të burimeve në dispozicion dhe një bashkërendim të punës jo vetëm ndërmjet strukturave të Bashkisë Korçë që kontribuojnë në zhvillimin e rinisë por edhe bashkërendimin e punës së institucioneve në të gjitha nivelet e qeverisjes. Në fokus ishte krijimi i sinergjive nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile, organizatave ndërkombëtare dhe bizneseve.

Gjashtë shtyllat kryesore mbi të cilat u bazua Plani Lokal i Veprimit për Rininë ishin si vijon:

1. *Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës;*
2. *Punësimi dhe sipërmarrja rinore;*
3. *Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor;*
4. *Mbështetja e organizatave dhe nismave rinore;*
5. *Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike për të rinjtë.*

3.2. PLANI SOCIAL, BASHKIA KORÇË (2024-2027)⁹

Plani Social i Bashkisë Korçë (2024-2027) u mundësua nga mbështetja e Programit "Leave No One Behind" i Kombeve të Bashkuara. Ky program është i angazhuar për të mbështetur reformën e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Shqipëri në përgjigje të përpjekjeve të qeverisë shqiptare për të mundësuar përfshirjen sociale të grupeve në nevojë. Në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë qendror programi LNB po mbështet Bashkitë për të zhvilluar, zbatuar dhe monitoruar Planet

⁹ Plani i Mbrojtjes Sociale, Bashkia Korçë 2024 – 2027.

kanë konsideruar shërbimet elektronike/online, si ndihmuese për një mbështetje të përgjithshme, ndërsa për çështje të rëndësishme dhe specifike preferojnë që ky shkëmbim informacioni dhe mbështetje të bëhet personalisht me një specialist të fushës respektive.

Një ndër sfidat më të cilat të rinjtë në Europë janë përballur ndër vite dhe që të rinjtë në Shqipëri po përballen sot, është ekzistenca e një numri të konsiderueshëm shërbimesh të integruara me në fokus fuqizimin e tyre, por të fragmentuara! Në këtë pikë nëse një i ri ose e re ka shumë çështje për të diskutuar, i duhet që të zhvillojë takime të shumta në zyrë të ndryshme me ekspertë të ndryshëm. Kjo do të thotë që asnjë ofrues shërbimi për të rinjtë nuk ka një pasqyrë holistike të situatës së klientit në të gjitha aspektet e jetës së tij.

Në vende të ndryshme të Bashkimit Europian, si për shembull Finlanda kjo sfidë e hershme e të rinjve ka marrë zgjidhje përmes zhvillimit dhe zbatimit të idesë për krijimin e Spoerteleve, Qendrave Udhëzuese me një Ndalesë në ndihmë të të rinjve. Në Finlandë, Qendra e parë Udhëzuese me një Ndalesë u hap në vjeshtën e vitit 2014 si pjesë e zbatimit të Garancisë Rinore në këtë shtet. Kjo praktikë më pas u përhap në mbarë vendin, duke sjellë idenë e partneritetit privat-publik në nivelet lokale dhe rajonale. Qëllimi i këtyre Qendrave Udhëzuese me një Ndalesë ishte që të përmbledhë të gjitha shërbimet e nevojshme, mbështetëse dhe fuqizuese për të rinjtë në një vend, me fokus në udhëzimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Përsa më sipër, për të përmbushur mungesën e këtyre shërbimeve mbështetëse komunitare për të rinjtë në Shqipëri, CRCA/ECPAT Shqipëri përgjatë vitit 2023-2024, me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Ministrisë të Shtetit për të Rinjtë dhe Fëmijët zbatuan dhe pilotuan për herë të parë modelin e Qendrës së Shërbimeve Rinore me një Ndalesë në Bashkinë e Korçës, Pogradecit, Maliqit dhe Devollit.

Qendra e Shërbimeve Rinore me një Ndalesë është një shërbim model unik, që sjell në një vend të vetëm të gjitha shërbimet publike dhe ato të OSHC-ve për të rinjtë dhe të rejtat, për të promovuar kujdesin, mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve për një jetë, punësim dhe karrierë të suksesshme. Qendra është një zyrë me një ndalesë që synon të drejtojë dhe mbështesë të rinjtë dhe të rejtat banues në territorin e Bashkive Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll, në rrugën e tyre nga mosha e arsimit bazë deri në moshën madhore. Qendra e drejtuar nga të rinjtë për të rinjtë synon të fuqizojë të rinjtë e grupeve më në nevojë dhe të krijojë një mjedis gjithëpërfshirës që i ndihmon ata të kapërcejnë pengesat që lidhen me arsimin dhe aksesin në tregun e punës. Kjo qendër u hap në Bashkinë Korçë – për shkak sepse shërbimet në nivel qarku janë të vendosura në këtë qytet, por që funksionon si një zyrë koordinuese për të gjithë të rinjtë në të katër bashkitë e këtij qarku.

Në fokus të ndërhyrjes, veprimtarisë dhe shërbimeve të Qendrës janë të rinjtë e të rejtat për të fuqizuar kapacitetet e tyre në arsimin joformal, informim dhe garantim të aksesit në shërbimet me bazë komunitare si dhe orientimin e tyre drejt tregut të punës për të hedhur hapa drejt një

Qendra e Shërbimeve Rinore me një Ndalesë ofron një larmi të madhe shërbimesh ndërsektoriale. Rrjeti i gjerë i partnerëve përfshin këshilltarët për të rinjtë, punonjës socialë, psikologë, profesionistë të sektorit të shëndetit, ekspertë të punësimit, edukimit dhe arsimit profesional, si dhe një sërë ofruesish të tjerë shërbimesh nën një çati. Shërbimet ofrohen përmes kanaleve të ndryshme, të tilla si: ballë për ballë, elektronike, online ose/dhe telefonike.

Këto shërbime synojnë të trajtojnë aspekte të ndryshme të jetës së të rinjve dhe të rejave në Korçë, Pogradec, Devoll dhe Maliq, duke i ofruar atyre burimet dhe mbështetjen e nevojshme për rritjen, zhvillimin dhe suksesin personal. Shërbimet e ofruara mund të ndryshojnë në varësi të problematikave dhe vendndodhjes së të rinjve e të rejave. Qendra e Shërbimeve Rinore me një Ndalesë ofron një sërë shërbimesh të përshtatura për të përmbushur nevojat e ndryshme të të rinjve, si vijon: 1) *Edukimi dhe Mësimdhënia*; 2) *Shërbimet e Punësimit*; 3) *Shëndeti dhe Mirëqenia, Literatura Digjitale, Siguria dhe Zhvillimi i Aftësive*; 4) *Aftësitë e Jetës*; 5) *Zbavitje dhe Argëtim*; 6) *Asistencë Juridike*.

3.4. QYTEZA E FËMIJËVE NË KORÇË

"Qyteza e Femijeve" në Korçë filloi si projekt në vitin 2013 dhe përfundoi disa vite më vonë me synimin për të ofruar një ambient të sigurt dhe të këndshëm për fëmijët e qytetit dhe për të promovuar aktivitete edukative dhe argëtuese.

"Qyteza e Fëmijeve" në Korçë është një park dhe qendër për fëmijë, që ofron një ambient të sigurt dhe të këndshëm për të luajtur dhe mësuar. Ky kompleks përfshin një hapësirë të madhe me lojëra dhe aktivitete për fëmijë të moshave të ndryshme, dhe shpesh organizohen atje aktivitete edukative dhe kulturore.

Qyteza është një vend i veçantë në Korçë, duke kontribuar në zhvillimin e aktivitetit fizik dhe social të fëmijëve, si dhe duke ofruar mundësi për familjet që të kalojnë kohë të kualitetit së bashku. Për më shumë informacion në lidhje me oraret e hapjes, aktivitetet dhe mundësitë që ofron, mund të kontaktoni qendrën direkt ose të kontrolloni faqet lokale të informacionit.

"Qyteza e Femijeve" në Korçë ofron një gamë të gjerë shërbimesh dhe aktiviteteve për fëmijët dhe familjet. Ky kompleks është ndërtuar për të ofruar një ambient të sigurt dhe të këndshëm për zhvillimin dhe argëtimin e fëmijëve. Disa nga shërbimet dhe aktivitetet që ofrohen në këtë qendër përfshijnë:

1. *Park dhe Lojëra*: Ka hapësira të dedikuara për lojëra, të cilat përfshijnë pajisje për të luajtur, si rrëshqitëse, litarë, dhe të tjera lojëra të përshtatshme për moshat e ndryshme.

administrim të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke krijuar një dobësim dhe çorientim rrënjësor të të gjithë sistemit institucional për rininë në Shqipëri.

Pavarësisht ekzistencës së Shërbimit Kombëtar të Rinisë deri në vitin 2020, i cili përfshinte tre Qendra Rinore në Korçë, Vlorë dhe Tiranë, implementimi dhe monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë u përball me disa sfida. Mungesa e një strukture institucionale të qartë dhe të qëndrueshme në nivel qendror dhe lokal ndikoi në realizimin e plotë të aktiviteteve të planifikuara dhe në arritjen e objektivave të vendosura. Edhe pse Planit parashikonte ngritjen e një grupi ndër-ministërial për monitorimin e tij, ky grup nuk u krijua dhe nuk funksionoi. Gjithashtu, struktura e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Sporteve dhe Rinisë ishte e kufizuar në staf dhe kapacitete për t'u angazhuar plotësisht në çështjet e rinisë, me vetëm 2 persona të dedikuar për këtë fushë. Kjo ka krijuar një mungesë të informacionit të qartë rreth rolit dhe përgjegjësi të strukturave dhe ka bërë të vështirë sigurimin e shërbimeve efikase për të rinjtë.

Një ngjarje e rëndësishme është riorganizimi i ministrive në vitin 2017, i cili solli dhe shkrirjen e Drejtorisë së Politikave Rinore në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave rinore. Me këtë ndryshim, u krijua për herë të parë pozita e Zv. Ministrit për Rininë, një hap i rëndësishëm për përmirësimin e lidhjes institucionale midis të rinjve dhe MASR-së. Megjithatë, edhe pse u themelua ky portofol dhe u bashkua rinia në Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, nuk u krijua ende një sektor apo një drejtori përkrah Shërbimit Kombëtar të Rinisë që të merrej vetëm me çështjet e rinisë, duke e bërë të vështirë adresimin e plotë të nevojave dhe sfidave me të cilat përballen të rinjtë dhe të rejtat.

Kotër vite më vonë (2021) për çështjet e të rinjve dhe fëmijëve u krijua Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka si mision mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe garantimin e pjesëmarrjes së tyre në jetën sociale, nëpërmjet hartimit, zhvillimit dhe monitorimit të politikave rinore, dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe mirëedukimin e fëmijëve. Ministri i Shteti për Rininë dhe Fëmijët synon të fuqizojë përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse të politikëbërjes, duke mbrojtur të drejtat e të rinjve, duke krijuar kushte të nevojshme për aktivizim e pjesëmarrje.

Si institucion përgjegjës me në fokus rininë dhe fëmijët, Ministri i Shtetit krijon ura bashkëpunimi mes fëmijëve dhe të rinjve të Shqipërisë e atyre të diasporës, me përfaqësuesit e institucioneve publike e private, si dhe me organizata të shoqërisë civile që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë.

Përsa më sipër, referuar misionit të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, por dhe Ligjit për Rininë, planifikohet që Ministri në fjalë të mund të hartojë, zbatojë dhe monitorojë mbarëvajtjen e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029. Sipas ekspertëve të ndryshëm të fushës së rinisë, bazuar edhe tek organigrama e Ministrit të Shtetit me një staf të reduktuar dhe pa portofol ende nuk është krijuar një Sektor/Drejtori Rinie për përgatitjen e raporteve periodike të zbatimit të

Këshilli Kombëtar i Rinisë¹¹

Këshilli Kombëtar i Rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë ministrit përgjegjës për rininë. Këshilli Kombëtar i Rinisë ushtron kompetencat vijues: a) i paraqet ministrit përgjegjës për rininë politikat prioritare, buxhetin dhe veprimtaritë në fushën e rinisë; b) propozon drejtimet dhe programet kryesore për mbështetjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së të rinjve; c) jep mendim për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe monitoron zbatimin e saj; ç) miraton raportin vjetor mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe situatës së të rinjve. Këshilli Kombëtar i Rinisë kryesohet nga ministri përgjegjës për rininë dhe ka në përbërje 14 deri në 16 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Rinisë emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për rininë.

Këshilli Vendor i Rinisë¹²

Bazuar tek Ligji për Rininë, Këshilli Vendor i Rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Këshilli Vendor i Rinisë ushtron kompetencat si vijim: a) këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë; b) vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor; c) propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë; ç) bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë. Këshilli Vendor i Rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.

Përsa më sipër, vlen të theksohet se edhe Bashkia e Korçës prej vitesh ka ngritur Këshillin Vendor të Rinisë që përbëhet prej 9 (nëntë) të rinj e të reja si vijim dhe që deri më tani ka funksionuar më së miri: *Xhoni Pajo, Kamila Busho, Entela Maçka, Stefan Simaku, Blevisa Dajko, Flavia Zere, Tomas Menkshi, Gabriela Ahmeti dhe Ervin Dallku.*

Sektori i Rinisë në Bashki

Bazuar tek Ligji për Rininë, Neni 7, pika e, çdo Njësi e Vetëqeverisjes Vendore duhet të krijojë strukturën administrative për çështjet e rinisë! Referuar këtij Neni, si dhe bazuar tek organigrama e Bashkisë Korçë rezultoi se ende nuk është ngritur një drejtori apo sektor i veçantë për rininë. Kjo gjë është zgjidhur nga Bashkia e Korçës duke vendosur në funksion të të rinjve një Këshilltar për Çështjet e të Rinjve pranë kabinetit të kryetarit të bashkisë.

¹¹ Ligji Nr. 75-2019 "Për Rininë", lidhja në linkun vijues: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Permbledhje-e-ligjit-dhe-akteve-n%C3%ABnligjore-n%C3%AB-fush%C3%ABn-e-rinis%C3%AB.pdf>

¹² Ligji Nr. 75-2019 "Për Rininë", lidhja në linkun vijues: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Permbledhje-e-ligjit-dhe-akteve-n%C3%ABnligjore-n%C3%AB-fush%C3%ABn-e-rinis%C3%AB.pdf>

V. TË RINJTË NË KORÇË, TË DHËNA DEMOGRAFIKE

Sipas CENS 2023, popullsia e Qarkut të Korçës është 173,091 banorë, ndërsa në Bashkinë e Korçës jetojnë 60,754 banorë. Në kuadër të Ligjit Nr. 75/2019 "Për Rininë", grup-mosha e rinisë që përfshihet për qëllime të politikave rinore është nga 15 deri në 29 vjeç. Në këtë kontekst, ky Plan Lokal është i fokusuar në këtë grup-moshë dhe synon përmirësimin e kushteve të jetesës, mundësitë për zhvillim profesional dhe përfshirjen e rinisë në aktivitete të ndryshme shoqërore dhe kulturore në Bashkinë e Korçës.



KOMITET	Numri i popullsisë në 15 Shtator 2023	Shpërndarja e popullsisë sipas gjëslisë (%)		Bilanci i përqendrimit banor (Numër)	Bilanci i zakonshme të banorëve (Numër)	Niveli i familjes (Numër)
		Meshkuj	Femra			
Durrës	25 807	50,1	49,9	8 135	6 362	6 583
Kufundë	7 519	50,7	49,3	2 834	2 785	2 827
Korçë	60 754	49,9	50,1	14 487	20 586	21 427
Malë	31 008	51,5	48,5	10 527	9 190	9 623
Pogradec	46 070	50,6	49,4	13 137	14 372	14 691
Pushtet	1 843	50,5	49,5	1 061	684	728

Bazuar në analizat dhe të dhënat e CENS 2023, grup-mosha 15-29 vjeç përbën 15% të popullsisë së Bashkisë së Korçës, që i korespondon një numri prej 26,848 individësh. Ky segment i popullsisë është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e politikave rinore, pasi përfaqëson një pjesë të konsiderueshme të komunitetit që është në faza kyçe të jetës: *arsimi, integrimi në tregun e punës, zhvillimi profesional dhe angazhimi shoqëror*.

Kjo grup-moshë është gjithashtu ajo që ka mundësi të mëdha për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Bashkisë së Korçës, përmes angazhimit në aktivitete sociale, kulturore dhe profesionale. Disa nga sfidat kryesore që mund të adresohen për këtë grup përfshijnë mundësitë e punësimit, zhvillimi i aftësive profesionale, mundësitë për arsimim cilësor dhe përfshirja e rinisë në vendimmarrje dhe aktivitete shoqërore.

**IDENTIFIKIMI I
PROBLEMEVE,
NEVOJAVE DHE
PRIORITETEVE TË
RINISË**

Duke marrë në konsideratë 3 shtyllat kryesore të shqetësimit të të rinjve në Korçë: *arsimin, punësimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në qeverisje arritën të identifikohen problematikat*. Këto problematika janë identifikuar duke përdorur analizën SWOT-Srength, Weakneses, Opportunities, Threats- Pika të Forta, Pika të Dobëta, Mundësi, Riske. Problematikat janë kategorizuar sipas 5 prioriteteve dhe janë përkthyer në objektiva, të cilave i është bashkangjitur dhe një plan masash ose zgjidhje të mundshme. Në këtë kapitull të këtij Plan Veprimi bëhet një zbërthim i problematikës dhe përkatësi i tyre sipas 5 prioriteteve të identifikuara nga të rinjtë. Ndërsa në kapitullin e Prioriteteve bëhet një zbërthim i detajuar i mundësive të mundshme të zgjidhjeve. Identifikimi i të gjithë këtyre jep të qartë situatën reale të rinisë, e cila përmbledhet në 5 prioritetet kryesore:

1. *Punësimi dhe sipërmarrja rinore;*
2. *Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në politikë dhe vendimarrje;*
3. *Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës;*
4. *Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike për të rinjtë;*
5. *Mbështetja e organizatave dhe nismave rinore.*

PRIORITETI 1 - Punësimi dhe sipërmarrja rinore

Punësimi mbetet një nga shqetësimet kryesore të rinisë shqiptare dhe është një aspekt që meriton vëmendje të veçantë edhe në qytetin e Korçës. Pavarësisht përpjekjeve dhe angazhimit të vazhdueshëm të Bashkisë për përmirësimin e situatës, do të ishte ndihmuese zgjerimi i fokusit ndaj disa çështjeve specifike që adresojnë drejtpërdrejt nevojat e të rinjve. Për shembull, shtimi i marrëveshjeve të strukturuar mes Bashkisë dhe bizneseve lokale për punësimin e të rinjve, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i skemave të dedikuara për punësimin sezonal, mund të kontribuonin ndjeshëm në krijimin e më shumë mundësive. Gjithashtu, një vëmendje e shtuar ndaj motivimit të sipërmarrjes rinore dhe ofrimit të trajnimeve të specializuara do të ndihmonte në aftësimin e të rinjve për tregun e punës dhe rritjen e konkurrencës së tyre profesionale. Në këtë drejtim, Bashkia mund të luajë një rol kyç si koordinator dhe mbikëqyrës për të siguruar realizimin e këtyre iniciativave në territorin e saj. Për më tepër, krijimi i një burimi të qendëruar informacioni për punësimin rinor dhe hartimi i politikave që mbështesin sipërmarrjen rinore do të përfaqësonte një hap të rëndësishëm drejt fuqizimit të brezave të rinj. Në këtë mënyrë, Bashkia do të mund të forconte më tej rolin e saj si mbështetëse e zhvillimit të rinisë në qytet.

Ndërkohë, referuar faktit që Korça është një rajon i njohur për bukuritë natyrore dhe trashëgiminë kulturore, të rinjtë adreduan se Bashkia e Korçës duhet t'i kushtojë një rëndësi të veçantë turizmit rinor dhe agrikulturës që mund të ofronin mundësi të shkëlqyera për punësimin e të rinjve.

Masat e sugjeruara mbi problematikat në lidhje me punësimin dhe sipërmarrjen rinore janë adresuar duke marrë në konsideratë dhe bashkëpunime të mundshme me aktorë të tjerë, sidomos duke qënë se jo të gjitha zgjidhjet mund të ezaurohen nga Bashkia e Korçës.

përbën një sfidë që mund të adresohet për të mbështetur një zhvillim më të gjithanshëm të nxënësve.

Të gjitha këto problematika janë grupuar në PRIORITETI 3, ku më tej do adresohen zgjidhjet dhe opsionet e mundshme. Adresimi i tyre bëhet dhe me bashkëpunimin e institucioneve të pushtetit qendror dhe aktorëve të tjerë.

PRIORITETI 4 - Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike për të rinjtë.

Të rinjtë, si një grupim shoqëror me karakteristika dhe nevoja specifike, zakonisht gëzojnë shërbime të përshtatura për ta. Në qytetin e Korçës, këto shërbime janë zhvilluar dhe ofrohen mjaft mirë, duke përfshirë qendra rinore, shërbime shëndetësore dhe lehtësira për studentët dhe të rinjtë. Kjo bën që qyteti të konsiderohet një model pozitiv për kujdesin ndaj rinisë.

Megjithatë, e njëjta qasje duhet të shtrihet edhe për të rinjtë që jetojnë në zonat rurale të Bashkisë Korçë. Në këto zona, është e rëndësishme që të zhvillohen më tej qendrat rinore dhe sociale, si dhe të ofrohen shërbime të përshtatura që adresojnë nevojat e tyre për aktivitete dhe organizime. Kjo do të ndihmonte në krijimin e mundësive të barabarta dhe përfshirjen e plotë të rinjve në zhvillimin e komuniteteve ku ata jetojnë.

Ndërsa për të gjithë të rinjtë vërehet një mungesë shërbimesh për orientime shëndetsore dhe shoqërore, si mungesa e edukatës seksuale, të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme apo grupime të tjera problematikash shëndetsore për të cilat të rinjtë janë identifikuar si grup vulnerabel apo në nevojë informacioni.

Studimet tregojnë se "të rinjtë janë ndërmjet konsumatoreve kryesore të duhanit, ku shifrat si për meshkujt edhe për femrat qëndrojnë mbi mesataren kombëtare (FES Albanian Youth 2011). Ndonëse meshkujt janë konsumatorët kryesorë të alkolit, gjatë weekend-eve të dy gjinitë konsumojnë njësoj alkol.¹⁵ Përdorimi i drogës është një tjetër shqetësim, sidomos nëpër gjimnazet e Korçës, si dhe në lokalet e jetës së natës në Korçë. Një problem tjetër në fushën e shëndetit është përhapja e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST) dhe HIV-it. Braktisja e vlerave tradicionale, pasja e partnerëve të shumtë apo seksi i pambrojtur, janë faktorë që kanë çuar në rritjen e incidencës së këtyre sëmundjeve ndër të rinjtë.

Për të vazhduar më tej, duhet të intensifikohet puna për të ofruar shërbime dhe informim të specializuar për të rinjtë me aftësi të kufizuara. Aktualisht, ka një nevojë për shtimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe parandalues për sjelljet që mund të ndikojnë negativisht në shëndetin apo mirëqenien shoqërore të të rinjve.

Gjithashtu, duhet të zhvillohen plane dhe politika që adresojnë në mënyrë të veçantë nevojat e të rinjve që gjenden në situata të vështira ekonomike dhe sociale. Përfshirja e aktiviteteve informuese dhe mbështetëse do të ndihmonte në krijimin e mundësive të reja për këtë grup të rinjsh, duke rritur aksesin e tyre në mbështetje dhe burime të përshtatshme.

¹⁵ "Albanian Youth 2011: Between present hopes and future insecurities", FES Tirana & IDRA. 2013, fq. 20

**MATRICA E PLANIT
TË VEPRIMIT PËR TË
RINJTË 2025-2028**

	2. Vazhdimi i organizimit të panairëve të punësimit sezonal, si një mundësi për të rinjtë në Korçë për të gjetur mundësi pune, në veçanti duke shfrytëzuar potencialin e turizmit si një sektor kyç të strategjisë së Bashkisë Korçës.			Sektori i Integritimit European, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit, Bashkia e Korçës, Këshilli Bashkiak i Korçës.
Aftësimi efikas dhe proaktiv i të rinjve për tregun e punës,	1. Vazhdimi i zhvillimit të trajnimeve të ndryshme për aftësimin e të rinjve në tregun e punës, duke ofruar mundësi për rritjen e kompetencave dhe aftësive profesionale që janë të nevojshme për të përballuar sfidat e tregut të punës dhe për të mundësuar integrimin e tyre në sektorë të ndryshëm ekonomikë (siç është shembulli pozitiv i Korça Innovation Hub).	* Numri i trajnimeve të zhvilluara. * Numri i të rinjve të trajnuar.	Janar 2025- Dhjetor 2026	Drejtorja e Rinisë/Këshilltari i Rinisë, Drejtoria e Turizmit, Projekteve, Zhvillimit dhe Migracionit e Diasporës, Drejtoria e Kujdesit Social, Sektori i Integritimit European, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit, Bashkia e Korçës, Këshilli Bashkiak i Korçës, OSHC-të Rinore.

2. Krijimi i mundësive për punësim në sektorë të lidhur me turizmin, si shërbimi ndaj klientit, menaxhimi i Informacionit për turistët dhe më shumë.

Kultivimi dhe Përpunimi i Produkteve Bujqësore:

1. Nxitja e praktikave moderne në bujqësi, si bujqësia organike dhe teknologjitë e reja në kultivimin e kulturave. *Të rinjtë mund të trajnohen dhe të angazhohen në këto aktivitete.*

2. Zhvillimi i industrisë së përpunimit të produkteve bujqësore, si ndërtimi i fabrikave të përpunimit të frutave dhe perimeve.

Mbështetje për Sipërmarrësit e Rinj në Bujqësi:

1. Ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes për të rinjtë që dëshirojnë të krijojnë bizneset e tyre në sektorin e bujqësisë.

2. Krijimi i mundësive për grante dhe kredi për të rinjtë që dëshirojnë të investojnë në bujqësi dhe të krijojnë punësim të qëndrueshëm.

3. Organizimi i kurseve dhe trajnimeve për aftësi në bujqësi dhe menaxhim të fermave. Të rinjtë

organike dhe teknologjitë e reja në kultivimin e kulturave.

* Numri i të rinjve të angazhuar në këto praktika.

* Numri i fabrikave.

* Numri i trajnimeve për të rinjtë që dëshirojnë të krijojnë bizneset e tyre në sektorin e bujqësisë.

* Numri i kredive të alokuara për të rinjtë që dëshirojnë të investojnë në bujqësi dhe të krijojnë punësim të qëndrueshëm.

* Numri i trajnimeve për aftësi në bujqësi dhe menaxhim të fermave.

* Numri i të rinjve të përfshirë në këto trajnime.

Ndërtimi i një pike informuese qëndore për punësimin dhe sipërmarrjen në 9 njësitë administrative në Korçë.	1. Ngritja e një strukture koordinuese për krijimin e një Portali Punësimi për të Rinjtë e Korçës. 2. Pasurimi i vazhdueshëm i Portalit me lajmërimi për vende të reja pune dhe trajnime për të rinjtë. 3. Rakordim i kërkesave për vende pune me ofertat e përshtatshme. 4. Rakordim i Portalit të Punësimit në Bashkinë e Korçës me Portalin Kombëtar të Punësimit të Rinjve.	* Struktura koordinuese; * Lajmërimet për punë dhe trajnime;	Janar 2026-Dhjetor 2027	Drejtoria e Rinisë/Këshilltari i Rinisë, Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit, Drejtoria e Turizmit, Projekteve, Zhvillimit dhe Migracionit e Diasporës, Drejtoria e Kujdesit Social, Sektori i Integritit Europian, Bashkia e Korçës, Këshilli Bashkiak i Korçës, OSHC-të Rinore.
---	---	--	-------------------------	--

Punësim & Sipërmarrje

- | | |
|---|--|
| 1. Internshipe të strukturuar për të rinjtë pa eksperiencë | 1. Numri i praktikave të realizuara çdo vit |
| 2. Kurse falas në IT, marketing digjital dhe menaxhim rrjetesh sociale | 2. % e vajzave të përfshira në trajnim dhe punësim |
| 3. Panairë karriere dhe forume punësimi | 3. Numri i bizneseve rinore që mbijetojnë |
| 4. Trajnime mbledhëse të qendrueshmërinë financiare të start-upeve rinore | |

pranë Këshillit Bashkiak.

2. Informim pro-aktiv i të rinjve për politikat dhe komisionet në lidhje me çështje që janë me interes për to.

3. Programe motivuese për pjesëmarrjen e të rinjve në politikbërje dhe qeverisje.

4. Ngritja e kanaleve të komunikimit mes Këshillit Bashkiak dhe të rinjve, sespe gjithmonë puna e këshillave nuk bëhet e njohur për të rinjtë e qytetit.

Alokimi dhe pasja e një buxheti nga Bashkia Korçës për të adresuar dhe përmbushur nevojat dhe kërkesat e të rinjve të qytetit.

1. Bashkia e Korçës duhet të alokojë një buxhet specifik për të rinjtë bazuar në nevojat reale të tyre. Buxhet ky i ndarë nga ai i inovacionit

2. Bashkia e Korçës, duhet të fillojë në kohë konsultimin dhe hartimin me pjesëmarrje të Buxhetit të Rinisë me të gjitha organizatat që punojnë me dhe për të rinjtë, Bordin Këshillimor si dhe Këshillin Rinor Vendor në qytetin e Korçës.

3. Organizatat rinore, Këshilli Rinor Vendor dhe të rinjtë e Korçës duhet të përfshihen

* Takimet konsultuese për buxhetin;

* Buxhet dedikuar të rinjve;

* Numri i organizatave, bordeve, këshillave dhe grupimeve rinore të përfshira në hartimin e buxhetit;

* Nevojat, prioritetet e të rinjve të pasyqruara në buxhet.

Janar
2025-
Dhjetor
2026

Drejtoria e Rinisë, Drejtoria e Politikave Sociale, OSHC-të Rinore

rinjve, Bashkisë Korçë dhe Këshillit Bashkiak Korçë.	dëgjimore të paktën 1 herë në 6 muaj për: 1. të diskutuar dhe konsultuar politika rinore, prioritete, problematika si dhe çështje të ndryshme për të rinjtë që jetojnë, punojnë dhe studiojnë në qytetin e Korçës. 2. të analizuar rezultatet e Bashkisë Korçë, Këshillit Bashkiak të Korçës referuar të rinjve. 3. të analizuar shpenzimin e Buxhetit të Rinisë së Bashkisë Korçë.	Bashkia e Korçës, Këshilli Bashkiak i Korçës, OSHC-të Rinore.
--	--	---

Pjesëmarrja
Rinore

- | | |
|--|---|
| 1. Zbatimi i Manualit të Këshillave Rinore Vendore
2. Raportim publik i KRV-së mbi rekomandimet e marra nga Bashkia
3. Buxheti me pjesëmarrje (1-2% e buxhetit zhvillimor për projekte rinore) | 1. Numri i rekomandimeve të KVR-së të reflektuara në politikat vendore
2. Numri i projekteve të votuara nga të rinjtë përmes buxhetit me pjesëmarrje |
|--|---|

	sidomos në financim dhe implementim.			
	4. Konsultimi me të rinj për përfshirjen e tyre në këtë proces duke u kujdesur që të jenë pjesë në hallka ku ato mund të kontribuojnë.			
	5. Ndërtimi i një plani pune me hapa konkret për realizimin e kësaj mase. Në këtë plan pune identifikohet qartësisht përgjegjësia e aktorëve përgjegjës për realizimin e secilës etapë.			
Ekzistenca, qëndrueshmëria dhe menaxhimi i mjediseve shumëfunktionale në institucionet arsimore në Korçë.	1. Krijimi i mjediseve multifunkionale (biblioteka, palestra të reja) 2. Rritja e investimeve në palestrat dhe bibliotekat ekzistuese pranë institucioneve arsimore, si kujdes maksimal për mirëmbajtjen e tyre. 3. Rivlerësimi për nga funksioni i hapësirave fizike ekzistuese brenda shkollave 9-vjeçare, të mesme dhe institucioneve të tjera arsimore. 4. Kontroll i vazhdueshëm për një përdorim më të mirë të të gjitha hapësirave fizike pronësi e çdo shkolle 9-vjeçare dhe të mesme. 5. Organizimi sistematikisht i aktiviteteve promovuese për nxënësit e shkollave 9-	* Numri i bibliotekave dhe palestrave të reja; * Numri i bibliotekave dhe palestrave të rikonstruara; * Buxheti i investuar për rikonstruktimin e palestrave dhe bibliotekave ekzistuese, si dhe hapjen e bibliotekave/palestrave të reja në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme; * Numri i aktiviteteve promovuese për nxënësit e shkollave 9-vjeçare, të mesme dhe studentët.	Janar 2025- Janar 2027	Agjencia e Mirëqenies dhe Kujdesit Social, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit, Bashkia e Korçës, Këshilli Bashkiak i Korçës.

OBJEKTIVA	NDËRHYRJE	INDIKATORËT	AFATET KOHORE	DREJTORITË PËRGJËGJËSE
Krijimi i shërbimeve miqësore për të gjithë të rinjtë e Korçës.	1. Shtimi i stafit (në Bashkinë e Korçës) të kualifikuar, eksperiencën dhe ekspertizën e nevojshme për të ofruar më tepër shërbime miqësore për të gjithë të rinjtë e Korçës. 2. Trajnimi i administratës së Bashkisë Korçë, si dhe institucioneve publike vartëse të saj, për të ofruar shërbime miqësore shëndetësore dhe sociale për të rinjtë duke ju referuar të drejtave të njeriut. 3. Tarifa e transportit publik falas/ose e reduktuar për çdo student/e në Korçë. 4. Të përmirësohen kushtet e transportit publik në Korçë.	* Numri i trajnimeve të zhvilluara; * Numri i punonjësve të administratës së trajnuar; * Numri i studentëve që përfitojnë transport publik falas ose me një cmim të reduktuar. * Kushtetë e transportit publik;	Janar 2025- Dhjetor 2028	Drejtoria e Rinisë/Këshilltari i Rinisë, Sektori i Integritetit Europian, Drejtoria e Kujdesit Social, Agjencia e Mirëqenies dhe Kujdesit Social, Bashkia e Korçës, Këshilli Bashkiak i Korçës, OSHC-të Rinore.
Garantimi i aksesit të të rinjve në: Informim; Ndërgjegjësim dhe Shërbime të ndryshme të cilat ofrohen nga Bashkia e Korçës.	1. Organizimi i takimeve, nismave, fushatave të ndryshme informuese nga Bashkia e Korçës për çeshtjet shëndetësore, sociale si dhe shërbimet publike. 2. Nxitja dhe mbështetja e krijimit të rrjeteve të Edukatorëve Bashkëmoshatar, nëpër gjimnaze, në komunitet e	* Numri i takimeve, fushatave ndërgjegjëse; * Numri i rrjeteve të edukatorëve bashkëmoshatarë; * Platforma online.	Janar 2026- Dhjetor 2028	Drejtoria e Rinisë/Këshilltari i Rinisë, Sektori i Integritetit Europian, Drejtoria e Kujdesit Social, Agjencia e Mirëqenies dhe Kujdesit Social, Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit,

gjinor, si dhe për të rinjtë që vijnë nga grupet e tjera të marxhinalizuara.	Korçës, dhe çdo shërbim konkret ta ofrojë bazuar në to. 3. Bashkia e Korçës duhet të rrisë gamën e shërbimeve të ofruara duke vlerësuar efektshmërinë e atyre ekzistueseve, si dhe ofrimin e shërbimeve të tjera të reja.			Kujdesit Social, Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit, Bashkia e Korçës, Këshilli Bashkiak i Korçës, OSHC-të Rinore.
Karta e Rinisë për të gjithë të rinjtë që jetojnë, studiojnë dhe punojnë në qytetin e Korçës.	1. Integrimi i Kartës së Studentit tek Karta Rinore dhe prodhimi i një karte rinore jo thjesht për studentët, por për të gjithë të rinjtë nga mosha 16-29 vjeç. 2. Bashkia e Korçës duhet të konsultohet me të gjithë të rinjtë, organizatat rinore për shërbimet që do të ofrohen nëpërmjet Kartës Rinore.	* Karta Rinore; * Takimet konsultuese.	Janar 2025 -Dhjetor 2028	Këshilltari i Rinisë, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Trajnimit dhe e Zhvillimit, Drejtoria e Mbrotjtjes dhe Përfshirjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Sportit, Drejtoria planifikimit të Shërbimeve Publike
Ofrimi i mbështetjes për të rinjtë me kushte të vështira ekonomike dhe sociale (të rinjtë me statusin e jetimit, të braktisurit, të rinjtë pa kujdes	1. Krijimi i një fondi të posaçëm për grupet e të rinjve në nevojë ekonomike dhe sociale duke i suportuar ata për: Banesa sociale, Ndihmë ekonomike. 2. Zhvillimi i një pakete me shërbime paskujdesi individuale për çdo të ri	* Fondi i posaçëm; * Paketa e Shërbimeve.	Janar 2025 - Dhjetor 2028	Drejtoria e Rinisë/Këshilltari i Rinisë, Sektori i Integritimit European, Drejtoria e Kujdesit Social, Agjencia e Mirëqenies dhe Kujdesit Social,

5. Informimi dhe bashkepunimi me të rinjtë gjatë procesit të largimit dhe vendosjes në familjen pritëse/kujdestare.

6. Monitorimi i rregullt i zbatimit të standarteve në familjen kujdestare për të rinjtë nga stafi bashkisë/njësitë administrative.

7. Identifikimi i familjeve kujdestare nga bashkia/njësitë administrative dhe mirëfunksionimi i Rregjistrit të familjeve kujdestare ku specifikohen familjet pritëse për të rinjtë që humbin kujdesin prindëror.

Aktivitetet për reduktimin dhe parandalimin e problematikave të ndryshme madhore për të rinjtë si bulizmi, obeziteti, sëmundjet kronike, infektive dhe IST-të.

1. Krijimi i një grupi të rinjsh vullnetarë, edukatorë-bashkëmoshatarë pranë Bashkisë Korçë, me qëllim që këta të fundit të ndërmarrin fushata të ndryshme sensibilizuese, ndërgjegjësuere dhe informuese për të rinjtë dhe problematikat më madhore me të cilat ata përballen.

2. Rritja e fushatave, nismave dhe aktiviteteve ndërgjegjësuere për tematikat sociale dhe

* Grupi i të rinjve vullnetarë, edukatorë-bashkëmoshatarë pranë Bashkisë Korçë.

* Fushatat, nismat dhe aktivitetet ndërgjegjësuere.

Janar 2025
- Dhjetor
2028

Drejtoria e Rinisë/Këshilltari i Rinisë, Sektori i Integritetit Europian, Drejtoria e Kujdesit Social, Agjencia e Mirëqenies dhe Kujdesit Social, Bashkia e Korçës, Këshilli Bashkiak i Korçës, OSHC-të Rinore.

Buxhetin për të Rinjtë të Bashkisë Korçë për mbështetjen e organizatave rinore të shoqërisë civile.	Rinjtë një zë të posaçëm përmes të cilit të mbështesë nismat e ndërmarra prej organizatave rinore dhe aktivistëve të rinj në qytetin e Korçës. 2. Marrëveshje me aktorë të tjerë (biznese sociale, CSOs, biznese, etj.) për kontribut në ngritje resursesh që u vijjnë në ndihmë organizatave rinore.	* Format e tjera mbështetëse të ofruara nga bashkia.		Integritimit European, Agjencia e Mirëqenies dhe Kujdesit Social, Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Bashkia e Korçës, Këshilli Bashkiak i Korçës, OSHC-të Rinore.
Programe dhe politika Incentivuese për mirëfunksionimin e organizatave dhe organizmave rinore.	1. Organizimi i Panairove të Organizatave Rinore, në të cilat këto të fundit të mund të takojnë donator, biznese dhe kompani të ndryshme. 2. Ofrimi i asistencës teknike dhe mjediseve fizike për aktivitetet vullnetare që organizojnë të rinjtë. 3. Mundësimi i shkëmbimeve të ndryshme rinore, mes të rinjve, organizatave Rinore me qytetet binjake me të cilat bashkia e Korçës ka lidhur marrëveshje.	* Numri i panairove të organizuara; * Numri i aktiviteteve të ndryshme të mshtetura teknikisht nga Bashkia e Korçës; * Numri i vizitave njohëse ms të rinjve.	Janar 2025- Dhjetor 2028	Drejtoria e Rinisë/Këshilltari i Rinisë, Sektori i Integritimit European, Agjencia e Mirëqenies dhe Kujdesit Social, Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Bashkia e Korçës, Këshilli Bashkiak i Korçës, OSHC-të Rinore,
OJF & Nisma Rinore	1. Fond për shërbime inovatore për të rinjtë 2. Platformë online për	* Numri i projekteve të reja të financuara çdo vit		

VIII. BUXHETIMI I PLANIT TË VEPRIMIT

Çdo fund-vit, Këshilli Vendor Rinor do të paraqesë planin e punës për vitin pas-ardhës për zbatimin e Planit Lokal të Veprimit, së bashku me buxhetin respektiv.

- **Ligji Nr. 69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar"**, lidhja në linkun vijues:
https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Ligji_Parauniversitar.pdf
- **Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Arsimin e Lartë"**, lidhja në linkun vijues:
https://unitir.edu.al/eng/wp-content/uploads/2019/08/Ligj_80-2015_22.07.2015.pdf
- **Ligji Nr. 15/2019 "Për Nxitjen e Punësimit"**, lidhja në linkun vijues:
https://akpa.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/ligj-nr-15-dt-13.3.2019_nxitja-e-punesimit.pdf
- **Ligj Nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"**, lidhja në linkun vijues:
<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2016/11/24/121-2016>
- **Ligji Nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor"**, lidhja në linkun vijues:
https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Ligji_Nr.44_2012_per_shendetin_mendor.pdf
- Faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, lidhja në linkun vijues:
<https://rinia.gov.al/misioni/>
- **Plani i Mbrojtjes Sociale, Bashkia Korçë 2024 – 2027.**
- **Raporti Kombëtar "Rinia në Shqipëri 2019"**, CRCA/ECPAT Shqipëri, Tirana 2019.
- **"Rinia Shqiptare 2011: Mes besimit për të ardhmen dhe dyshimit për të tashmen!"**, FES Tirana & IDRA. 2013, fq. 20.
- **Studimi "Rinia Shqiptare: Problemi apo Investimi i Shkëlqyer?"**, Lëvizja MJAFI, 2010.
- **"Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani i Veprimit 2022-2029"**, lidhja në linkun vijues:
<https://riniafemijet.gov.al/strategjia-kombetare-e-rinise-2022-2029-tashme-miraturar/>
- **VENDIM Nr. 541, datë 19.9.2018 PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË DREJTËSISË PËR TË MITUR DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2018–2021**, lidhja në linkun vijues:
https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/Strategjia-e-Drejtësisë-per-te-Mitur-PV_2018-2021_miraturar_VKM_nr.541_dt.19.9.2018.pdf

KRYETARE E KESHILLIT BASHKIAK
ANA VERUSHI